

AKT I THEMELIMIT
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“B.O.T.A COMPANY” SH.P.K

Sot, më 17/04/2024, në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë:

1. **Znj. Ada Ilia**, shtetase shqiptare, e datelindjes 06.05.1983 lindur ne Tiranë, dhe banuese ne Tiranë, Adresa: Rruga Myslym Shyri, Pallati 44, shk.2 Tiranë, zoteruese e pasaportes me numer BB3360002 dhe numer personal identifikimi: I35506061B.
2. **Znj. Alma Nathanaili**, shtetase shqiptare e datelindjes 11.06.1983, lindur ne Tiranë, dhe banuese ne Berlin, Adresa Eolliner Straße 12.A 10435, Berlin, Gjermani, zoteruese e pasaportes me numer BE1348072 dhe numer personal identifikimi: I35611143P.

I. Themelimi

1. Ortakët themelues vendosën për themelimin e shoqërisë "**B.O.T.A COMPANY**" Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën: Rruga Myslym Shyri, Pallati 44, shk.2, Tiranë, Shqipëri.
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Te ofroje sherbime te konsulences, per bizneset, SME-te, Start-ups dhe klientet, dhe te zbatoje projekte zhvillimore per donatoret nderkombetare, institucionet qeveritare brenda dhe jashte Shqiperise. Sherbimet e kompanise perfshijne asistence teknike per bizneset dhe institucionet qe kerkojne rritje, ne fushen e eksportit, inovacionit dhe qendrueshmerise ekonomike dhe ambjentale si dhe ekspertize ne lidhje me zhvillimin e aktiviteteve dhe permiresimin e performances se tyre ekonomike perfshire zgjidhje teknike per biznesin ne zhvillimin, gjetjen dhe aksesin drejt tregjeve te reja, dhe optimizimin e operacioneve te tyre. Kompania gjithashtu do te ofroje koncepte dhe zgjidhje teknologjike e dixhitale, perfshire sherbime te asistences teknike dhe operacionale mbi monitorimin dhe vleresimin e programeve zhvilluese, zbatimin e projekteve me qellim zhvillimin e sipermarrjeve dhe eksportit, projekte zhvillimi dhe kerkimore ne fushen turizmit, incentivimin e ekonomise, punesimitimin e te rinjve, sherbimeve te tregtise, dhe sherbimeve te konsulences ne sektorin e konkurrueshmerine se biznesit dhe inovacione sociale ne zonat rurale dhe urbane.

Gjithashtu do të zhvillojë dhe zbatojë projekte në fushën e edukimit alternativ, formësimin personal dhe profesional, ngritjen e kapaciteteve njerëzore në programe të njohura në rajon dhe ndërkombëtarisht. konkurrueshmerine se biznesit dhe inovacione sociale ne zonat rurale dhe urbane.

Kompania harton dhe zbaton Programe dhe Projekte ne fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve, planifikim projekti dhe buxhetimi, hartimin dhe zbatimin e proceseve te vleresimit, projekte partneriteti me shtetet fshqinje dhe rritjen e kapaciteteve te njohurive mbi zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. Kompania mund të kryejë çdo veprim që do të ketë lidhje me hapjen e degëve, të punësojë stafin teknik, të diplomuar, të blejë,

shesë, të japë me qira dhe shkëmbejë pasuri të paluajtshme, të luajtshme, makineri, pajisje dhe materiale; të marrë dhe të japë me qera pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, të ndërmarrë veprime financiare, të marrë kredi me ose pa garanci hipotekore të pasurive, të përfitojë grante financiare dhe private; të marrë dhe të japi pjesë dhe interesa në ndërmarrje dhe shoqëri të tjera, si dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e lidhura, të nevojshme për realizimin e objektivit të veprimtarisë së saj. Gjithashtu shoqëria do të kryejë dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni apo aktivitetet ndihmëse të veprimtarive si me sipër.

III. Statuti

Ortakët Themelues me anë të kësaj deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë .

IV. Kapitali Themeltar

1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Cdo ortak zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë

Ortakët zotërojnë kapitalin si më poshtë:

- **Ada Ilia** – 50 % 5000 (pesë mijë) Lekë
 - **Alma Nathanailli** – 50 % 5000 (pesë mijë) Lekë
2. Kuotat janë të zakonshme dhe secili ortak ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote.
 3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues.

V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë të çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:

Ada Ilia, shtetase shqiptare, e datelindjes 06.05.1983 lindur ne Tirane, dhe banuese ne Tirane zoteruese e pashaportes me numer BB3360002 dhe numer personal identifikimi: I35506061B

Akti i Themelimit është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 990, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ortakët

Znj. Ada ILIA

Ada Ilia
Hollm

Znj. Alma NATHANAILI

Alma Nathanaili

STATUT I SHOQERISE
“B.O.T.A COMPANY” SH.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 17/04/2024, në Tiranë, personat e mëposhtem:

1. **Znj. Ada Ilia**, shtetase shqiptare, e datelindjes 06.05.1983 lindur ne Tiranë, dhe banuese ne Tiranë, Adresa: Rruga Myslym Shyri, Pallati 44, shk.2 Tiranë, zoteruese e pashaportes me numer BB3360002 dhe numer personal identifikimi: I35506061B.
2. **Znj. Alma Nathanailli**, shtetase shqiptare e datelindjes 11.06.1983, lindur ne Tiranë, dhe banuese ne Berlin, Adresa Eolliner Straße 12.A 10435, Berlin, Gjermani, zoteruese e pashaportes me numer BE1348072 dhe numer personal identifikimi: I35611143P.

ne përputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 17/04/2024, themeluesit e mësipërm, vendosëm të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “**B.O.T.A COMPANY**” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Te ofroje shërbime të konsulences, për bizneset, SME-te, Start-ups dhe klientet, dhe të zbatojë projekte zhvillimore për donatorët ndërkombëtarë, institucionet qeveritare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shërbimet e kompanisë përfshijnë asistencë teknike për bizneset dhe institucionet që kërkojnë rritje, në fushën e eksportit, inovacionit dhe qëndrueshmërisë ekonomike dhe ambientale si dhe ekspertizë në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e performancës së tyre ekonomike përfshirë zgjidhje teknike

per biznesin ne zhvillimin, gjetjen dhe aksesin drejt tregjeve te reja, dhe optimizimin e operacioneve te tyre. Kompania gjithashtu do te ofroje koncepte dhe zgjidhje teknologjike e dixhitale, perfshire sherbime te asistences teknike dhe operacionale mbi monitorimin dhe vleresimin e programeve zhvilluese, zbatimin e projekteve me qellim zhvillimin e sipermarrjeve dhe eksportit, projekte zhvillimi dhe kerkimore ne fushen turizmit, incentivimin e ekonomise, punesimitin e te rinjve, sherbimeve te tregtise, dhe sherbimeve te konsulences ne sektorin e konkurrueshmërinë së biznesit dhe inovacione sociale në zonat rurale dhe urbane.

Gjithashtu do të zhvillojë dhe zbatojë projekte në fushën e edukimit alternativ, formësimin personal dhe profesional, ngritjen e kapaciteve njerëzore në programe të njohura në rajon dhe ndërkombëtarisht. konkurrueshmërine se biznesit dhe inovacione sociale ne zonat rurale dhe urbane.

Kompania harton dhe zbaton Programe dhe Projekte ne fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve, planifikim projekti dhe buxhetimi, hartimin dhe zbatimin e proceseve te vleresimit, projekte partneriteti me shtetet fshqinje dhe rritjen e kapaciteteve te njohurive mbi zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. Kompania mund të kryejë çdo veprim që do të ketë lidhje me hapjen e degëve, të punësojë stafin teknik, të diplomuar, të blejë, shesë, të japë me qira dhe shkëmbejë pasuri të paluajtshme, të luajtshme, makineri, pajisje dhe materiale; të marrë dhe të japë me qera pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, të ndërmarrë veprime financiare, të marrë kredi me ose pa garanci hipotekore të pasurive, të përfitojë grante financiare dhe private; të marri dhe të japi pjesë dhe interesa në ndërmarrje dhe shoqëri të tjera, si dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e lidhura, të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj. Gjithashtu shoqeria do te kryeje dhe cdo aktivitet tjetër te lejuar nga legjislacioni apo aktivite ndihmese te veprimtarive si me sipër.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.***

Neni 4 Selia

- 4. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga Myslym Shyri, Pallati 44, shk.2, Tiranë, Shqipëri.****

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **ALL 10,000 (dhjetë mijë lekë)** dhe zotërohet në masën 50% nga **Ada Ilia**, zotëruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **5000 (pesë mijë lekë)** dhe 50% nga **Alma Nathanaili** zotëruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **5000 (pesë mijë lekë).**

Kontributi i ortakëve është në para.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të behet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtëpërbllim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së

veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtroje kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet etjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 3 (tre) vjeçar emërimi: **Znj. Ada Ilia, shtetase shqiptare, e datelindjes 06.05.1983 lindur ne Tiranë, dhe banuese ne Tiranë, zoteruese e pashaportes me numer BB3360002 dhe numer personal identifikimi: I35506061B** ; madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Kreu IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Ekspertet

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrine likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza

Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“B.O.T.A COMPANY” SH.P.K

Znj. Ada ILIA



Znj. Alma NATHANAILI

